



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM Durrës

Nr. Prot.

Durrës, më datë . . 2025

URDHËR

Nr. 81 , datë 13.03.2025

PËR NJËSIMIN E DOKUMENTIT ADMINISTRATIV

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 11, pika "b", të ligjit nr.9154, datë 06.11.2003, "Për arkivat" dhe ligji 98/2016 "Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Dokumentet administrative të përpiluara sipas Normave tekniko-profesionale të Republikës së Shqipërisë duhet të jenë në përputhje me modelet bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Siglimi i kopjes së dytë të dokumenteve kryhet si më poshtë:

Konceptoi: *Nistore e emrit, pikë, mbiemri i plotë, nënshkrimi i konceptuesit.*

Pranoi: *Nistore e emrit, pikë, mbiemri i plotë, nënshkrimi i përgjegjës të strukturës së nivelit të parë (nëse ka).*

Miratoi: *Nistore e emrit, pikë, mbiemri i plotë, nënshkrimi i përgjegjës të strukturës së nivelit të dytë (nëse ka).*

Konfirmoi: *Nistore e emrit, pikë, mbiemri i plotë, nënshkrimi i zëvendësitarit, juristit, apo pozicionit tjetër të përcaktuar në rregulloren e brendshme të funksionimit të institucionit.*

3. Dokumentet të përpilohen me shkrim *Times New Roman*, me madhësi 12 dhe hapësira midis rreshtave të jetë 1.15, si dhe në anësore të lihen 3cm bosh, ndërsa në krye e në fund të faqes nga 2cm.

4. Dokumentet të përpilohen në bazë të rregullave drejtshkimore, ku të përdoren gwrmat (ë) dhe (ç), si dhe kryeradhët.

5. Struktura të shënohet në dokumentet administrative vetëm në nivelin e strukturës më të lartë (Departamentit ose Drejtorisë, ose Sektorit etj., sipas rastit) që ka konceptuar dokumentin. Titullari i institucionit është strukturë më vete, në rastin e dokumenteve të konceptuara nga ai dhe në këto dokumente shënohet si strukturë më vete emërtesa e titullarit sipas organikës.

6. Përjashtimisht, në rastet kur dokumentet janë produkt i pozicioneve të posaçme të punës, të parashikuara në ligj dhe që nuk janë strukturë më vete, pozicionet shënohen poshtë strukturës përkatëse, ku ndodhet pozicioni i posaçëm, sipas rastit, Struktura Përgjegjëse për Sinjalizuesit, Autoriteti Përgjegjës për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Oficeri i Sigurisë, Koordinatori për të Drejtën e Informimit, Njësia e Burimeve Njerëzore e të tjera.

7. Njësia e Prokurimeve, Grupi i Menaxhimit Strategjik, Komisioni Disiplinor, Komisioni i Ekspertizës, si dhe të gjitha njësitë e tjera të ngritura sipas ligjit specifik në nivelin më të lartë drejtues,

shënohen si nënstrukturë, poshtë strukturës me emërtesën e titullarit, sipas organikës së institucionit.

8. Sekretari-arkivi i institucionit njofton titullarin në të gjitha rastet kur shkresat nuk përpilohen sipas këtij urdhri.

9. Ngarkohen strukturat e institucionit, pozicionet e posaçme të punës, sipas ligjit, dhe sekretari-arkivi për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZV/KRYETARE

BESJANA QARXENAJ

